UDHËZIM
Nr. 3, datë 4.5.2012

PËR PËRCAKTIMIN DHE DOKUMENTIMIN E SASIVE TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS, TË IMPORTUAR PËR NEVOJAT E VETA, NGA SHOQËRITË E KËRKIMIT TË NAFTËS DHE TË VËNIES NË SHFRYTËZIM TË ZONAVE NAFTËMBAJTËSE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar, Ministri i Financave dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

UDHËZOJNË:

1. Shoqëritë e kërkimit të naftës dhe të vënies në shfrytëzim të zonave naftëmbajtëse, të cilat mund të importojnë nënprodukte të naftës, për nevojat e veta, të përjashtuara nga tatimi i akcizës, duhet të pajisen me autorizimin e përjashtimit nga akciza nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT). Për marrjen e këtij autorizimi, shoqëritë e kërkimit të naftës dhe të vënies në shfrytëzim të zonave naftëmbajtëse duhet të paraqesin në DPT:

a) Një kërkesë me shkrim, së cilës i bashkëngjitet një fotokopje e certifikatës së NIPT-it;

b) Autorizim (origjinal) të lëshuar në emër të tij nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), ku të jepen referenca për marrëveshjen me Qeverinë Shqiptare, si dhe një kopje të kësaj marrëveshjeje;

c) Nevojat për nënproduktet e naftës, lloji i nënproduktit, sasinë që do të përdoret dhe periudhën e përdorimit.

2. Me plotësimin e dokumentacionit të mësipërm, brenda 30 ditësh kalendarike DPT pajis shoqërinë e kërkimit të naftës me autorizimin e përjashtimit nga akciza. Një kopje e autorizimit dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD).

3. DPT dhe DPD, nëpërmjet degëve të tyre, kontrollojnë dokumentacionin dhe lëvizjen fizike të nënprodukteve të naftës gjatë transportit, magazinimit, si dhe destinacionin e përdorimit.

4. Administrimi i këtyre procedurave, kontrolli dhe saktësimet përkatëse do të bëhen në përputhje me ligjin nr. 8976 datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar.

5. Nëse sasia e karburantit, e përjashtuar nga akciza, nuk shfrytëzohet brenda periudhës kohore të përcaktuar nga kompania, pjesa e pashfrytëzuar i nënshtrohet tatimit të akcizës.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

MINISTRI I EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Nasip Naço